



Prishtinë, 30.11.2012
Kodi i ZRRE-së: V_484_2012

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) të dhëna me Nenin 14 pika 2.6 dhe Nenin 43, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 03/L-185;
- Dispozitat e Nenit 17 të Ligjit për Energjinë Nr. 03/L-184; dhe
- Kërkesën e Ngrrohtores së Qytetit (NQ) Termokos SH.A për shqyrtimin e tarifave të ngrohjes qendrore, të datës 6 shtator 2012.

Në seancën e mbajtur me datë 30 nëntor 2012, nxori këtë:

VENDIM

- I. **APROVOHEN** tarifat e ngrohjes qendrore për Ngrrohtoren e Qytetit (NQ) Termokos SH.A. për sezonin e ngrohjes 2012/2013, siç janë paraqitur në tabelat "A" dhe "B".

Arsyetim

1. Me datë 6 shtator 2012 Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka pranuar kërkesën e Ngrrohtores së Qytetit (NQ) Termokos SH. A. për shqyrtimin e tarifave të ngrohjes qendrore.
 2. Për vendosjen e tarifave të ngrohjes qendrore, ZRRE ka marr parasysh:
 - Të Ardhurat e Lejuara siç janë përcaktuar në dokumentin: Përcaktimi i të Ardhurave të Lejuara për NQ Termokos SH.A. – Sezoni i Ngrrohjes 2012/2013; dhe
 - Llogaritjen e detajuar të tarifave siç paraqitet në dokumentin: Përcaktimi i Tarifave për NQ Termokos SH.A. – Sezoni i Ngrrohjes 2012/2013.
 3. Duke marr parasysh dispozitat ligjore të cekura në hyrje dhe duke u bazuar në shqyrtimin e të gjitha shkresave dhe dokumenteve relevante, Bordi ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II. Struktura e tarifave të Ngrrohtores së Qytetit Termokos SH.A. për sezonin e ngrohjes 2012/2013 është dhënë në tabelën e mëposhtme:



TARIFAT PËR NGROHTOREN E QYTETIT TERMOKOS SH.A.
PËR SEZONIN E NGROHJES 2012/2013

Tabela A. TARIFA PËR KONSUMATORËT PA MATJE

NGROHTORJA E QYTETIT TERMOKOS SH.A.		
Komponentët e Tarifave	Konsumatorët shtëpiakë	Konsumatorët Komerเชียลë e Institucionalë
Tarifa për kapacitetin e kontraktuar të ngrohjes (komponenta fikse)	0.07 [€/m ² për muaj]	0.08 [€/m ² për muaj]
Tarifa për ngrohjen e furnizuar (komponenta variabile)	0.77 [€/m ² për muaj]	0.92 [€/m ² për muaj]

Tabela B. TARIFA PËR KONSUMATORËT ME MATJE

NGROHTORJA E QYTETIT TERMOKOS SH.A .	
Tarifa për kapacitetin e kontraktuar të ngrohjes (komponenta fikse)	0.66 [€/kW për muaj]
Tarifa për ngrohjen e furnizuar (komponenta variabile)	45.50 [€/MWh]

- III. NQ Termokos SH.A duhet ta publikoj këtë vendim, brenda pesë (5) ditëve të punës pas shpalljes dhe publikimit të këtij vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, në së paku një prej gazetave ditore me qarkullim më të gjerë në Kosovë.
- IV. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka të drejtë, që të auditojë regjistrat e kontabilitetit dhe faturat e NQ Termokos SH.A. për të verifikuar realizimin e të dhënave të paraqitura nga NQ Termokos SH.A. në aplikacionin për tarifa.
- V. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente, brenda katërbëdhjetë (14) ditëve, nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, Kryesues

Përparim Kabashi, Anëtar

Blerim Koci, Anëtar

Merita Kostari, Anëtare

Krenar Bujupi, Anëtar